



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 30.06.2021

**NJOFTIM**

**ULET VIJA E FINANCIMIT PËR MASAT MBËSHTETËSE DIREKTE TË VITIT 2021**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen e vijës së financimit për aplikimet sipas masave mbështetëse të fermerëve dhe sipas listave të shpallura, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 3 datë 26.02.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i MBZHR dhe MFE.

Njoftimi mbi uljen e vijës së financimit për “**Listat e Aplikimeve të Kualifikuara**”, të cilat gjenden në faqen zyrtare: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), për masa mbështetëse direkte, financuar nga Programi Kombëtar, viti 2021.

**Agropikat** janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit.

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve që janë përfshirë mbi vijën e financimit.

- **Masa 1:** Tufa bazë e matrikulluar – Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 1857
- **Masa 2:** Parqet me koshere bletësh – Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 675.
- **Masa 3:** Zëvendësim plasmasi në sesa ekzistuese – Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 395.

Afati i dorëzimit të dokumenteve shtesë për aplikantët që ndodhen mbi vijën e financimit është deri më datë **15.07.2021**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.